

INTERVISTË ME MILAJETE SHALA MEHMETIN

Prishtinë | Data: 25 shtator, 2024

Kohëzgjatja: 79 minuta

Të pranishëm:

- Milajete Shala Mehmeti (E intervistuar)
- Anita Susuri (Intervistuesja)
- Ana Morina (Kamera)

Simbolet e komenteve në transkriptë të komunikimi jo-verbal:

() - komunikim emocional

{ } - i intervistuari shpjegon me gjeste

Simbole të tjera në transkriptë:

[] - shtesë e tekstit për të lehtësuar kuptimin

Fusnotat janë shtesa editoriale që japin informacion mbi vendbanime, emra apo shprehje.

Pjesa e Parë

Anita Susuri: Zonja Milajete nëse mundeni me u prezantu edhe me na tregu diçka për prejardhjen, familjen e ju?

Milajete Shala Mehmeti: Unë jam Milajete Shala. E lindur në Mitrovicë. Profesoreshë kam qenë në Fakultetin Xehëtar-Metalurgjik, ashtu quhej në Mitrovicë. Prejardhjen e kam nga familja poashtu Shala që kanë jetu në Saritër, ashtu quhej. Vendodhja e Trepçës sot. Familja ime, paraardhësit e mi kanë qenë pronar të tokës ku sot osht' Miniera e Trepçës. Për herë të parë e shesin tokën ose ua blejnë anglezët dhe aty ndërtohet miniera. Ata marrin, pra paguajnë anglezët shumë pare dhe kërkojnë që fëmijët t'i shkollojnë. Por, gjyshi im ka pasë fmitë shumë t'vogël dhe ai nuk ka mujtë me i çu jashtë. Megjithatë i ka shkollu pak, sa ka mujtë mrena.

Axha i madh ka qenë nivel të inxhinierit që ka punu në Trepçë. Ashtu familja ime vendosë që unë t'jem, ose dikush prej nesh që ishim shtatë fmi. Dikush prej nesh të studioj një prej degëve të cilat janë kshu adekuate për Trepçën. Mu m'bjen hatri. Që ishte e pazakontë që në atë kohë femrat të studiojnë inxhinierinë. Shumë pak femra kishte në inxhinieri. Megjithatë unë përfundova studimet dhe vazhdova në fakultet të punoj, jo në Trepçe. Edhe pse bursën e kisha qysh nga shkolla e mesme prej Trepçës. Shkolla e mesme ishte shkollë teknike që sot osht', osht' e ndarë. Pra, vetëm serbët shkojnë. Në shkollë teknike që ishte për krejt Kosovën minierat që ishin ose fabrikat e këtij lloji.

Aty prej asaj meniherë shkova në studime. Për herë të parë u hap fakulteti i teknologjisë në Kosovë që ishte kryesorja për shkak të Minierës së Trepçës dhe elektranëve që quhej. Atëherë KEKU. për ni moment sa kishte nevojë Trepça edhe KEKU për asi kuadrash sa që ata i morën listat që derisa u hap fakulteti kaloj ni kohë, ishte afër vitit të ri. Me thanë nëntori fillim. Ata i morën listat. Të dyja, Trepça dhe KEKU dhe i ndan kush don me marrë bursë nga elektrana kush don nga Trepça. Sipas dëshirës. Elektranat KEKU i sotshëm, pak ma t'mdhaja ishin bursat, shumë pak që dallojnë. Unë vendosa ta marr në KEK. Meqenëse e kisha shkollës së mesme bursën nga Trepça, ta ndrojo pak.

Kur e kreu fakultetin megjithatë unë u deshta të punoj atje. Deshta në Mitrovicë, fakulteti ishte në Mitrovicë. Në atë kohë pak para diplomimit punova në shkollë të mesme si inxhinier. Prej aty kalova në

fakultet. Meqenëse nuk shkova në KEK të punoj atëherë duheshe ta kthej bursën. E ktheva bursën, e ktheva. Që atëherë nuk ishte pak. Vazhdova prej aty prej shkollës së mesme në fakultet. Unë gjithë jetën kam punu në fakultet. Prej aty dola në pension.

Anita Susuri: Zonja Milajete po du pak me u kthy me do pyetje lidhur fillimisht me fëmijërinë e juaj. Më tregut që e kanë shitë atë tokën familja e juaj, jeni vendosë në Mitrovicë. Qysh e kujtoni atë kohën e rritjes në Mitrovicë?

Milajete Shala Mehmeti: Në Mitrovicë çka me thanë. Aty në atë kohë, vitet e '50-ta, ishte kohë tjetër po mund të thuhet që unë kur shkova ishin fillet e zhvillimit të shoqërisë tonë. Shumë herët. Domethanë sikur fëmija që i bën hapat e parë ashtu Kosova filloj pak. Megjithatë ishte në kohë e vështirë deri '68-ten. Pas '68-tes që unë isha në shkollë të mesme filloj ma shpejt me shku përpara shoqëria kosovare dhe Kosova.

Anita Susuri: Ju në kohën kur keni qenë në Mitrovicë po mendoj në cilën lagje ka jetu familja juaj?

Milajete Shala Mehmeti: Familja ime ka jetu në qendër afër tregut në Mitrovicë.

Anita Susuri: Qysh t'u kanë dokë shtëpitë në atë kohë? Rrugët? A kanë qenë shumë ma ndryshe?

Milajete Shala Mehmeti: Kanë qenë, ka pasë ni, me thanë, lum. Krahësim me Ibrin ajo degë e lumit po megjithatë e cila osht' qujtë luzhda. Andej pak ma lart shtëpisë time ka kalu luzhda. Pra, kah tregu. Ai shtrati i luzhdës ka qenë qaq i pa ndrequn, qaq i dobët saqë shumë shpesh vërshime ka pasë. Vërshimet nuk mrrishin te shtëpija ime po shumë afër, shumë afër. Atë e mbaj mend. Megjithatë në atë lum që ishte bovor, gjyna që e mbyllën mu m'kujtohet që ka pasë pata shumë dhe krejt të bardha ishin ato. Në atë kohë zgjidhjen e shihshin që ta mbyllin lumin që t'mos vij deri te vërshimet. Shumë ma lehtë ka qenë me ndreqë shtratin dhe nuk ka pasë mangësi.

Njerëzit i kanë maru shtëpijat zakonisht afër lumit. Pra, dy fajtor janë. Ai krye bashkiaku që s'ka mendu që duhet lumin me ndreqë, shtratin dhe kta që i kanë maru shtëpijat afër. U mbyll ajo. Për qata më vjen shumë keq.

Anita Susuri: Prindërit e juaj me çka janë marrë?

Milajete Shala Mehmeti: Prindërit e mi kanë pasë, baba im ka pasë shumë pasuni të cilën e trashëgoj prej babës t'vet. Ata duhej ta punosh. Ma vonë baba im e kreu në shkollë të mesme ose qatëherë kur kishte mundësi. Ma vonë e hap në dyqan që e jep në pjesë të pasurisë të vet afër shpisë dhe u mor me qata, me dyqane. Tjetër profesion... babës shpejt i vdes vllau në... sepse gjithë familja kishte ni, ma shumë ishte me të djathtët. Për luftën, pas Luftës së Dytë Botërore kur fitonin komunistat... në Mitrovicë që ka ndodhë në pushkatim i në grupit të djathtëve që kanë qenë me ballin kombëtar. Kshtu

më kujtohet. Te ni fqinj i joni i cili ishte edhe kusheri i babës, ose kusheri i gjyshës. Se baba im dajë i qunte ata, të Prekazit. Njëni prej atyre ndodhej në atë grupin që pushkatohej.

Prindt e mi edhe baba im ishte prej asaj familje. Të djathtit. Ata ndiqeshin kshtuqë si ka qenë atëherë në atë sistem nuk kishin të drejtë kurfar qasjes. Baba ka qenë ndër nxënësit ma të mirë në Mitrovicë. Serbët, serbët... në atë kohë ka qenë shumë e rëndë. E qesin nga shkolla, “Shko”. Ma ai s’ka pasë të drejtë me shku ma tutje në shkollë. Megjithatë ai ka pasë disa shokë edhe serb të cilët kanë vazhdu shkollimin. I ka pasë disa shok mjek bile karshi, serb. Po edhe mirë e ka çu me ta. S’ka pasë baba problem. Po qasjen në shkollim nuk ka pasë.

Anita Susuri: A ka ndodhë ndonjë konfiskim i pasurisë pas Luftës së Dytë?

Milajete Shala Mehmeti: Jo. Kshtu te dajtë gjyshi im ka qenë shumë i pasur dhe atje ia konfiskojnë pasurinë. Atij ia bijnë kusht ti ose, se ai qaq shumë ka pasë pasuri, i thonë, “Ti do zgjedhësh ose e ruan këtë dhe ne ta marrim atë ose shkon atje edhe t’ marrim këtu çka ke pasuri”. Ky e kishte gjyshi im atë burgun që osht’ rreth...

Anita Susuri: Burgun në Mitrovicë.

Milajete Shala Mehmeti: Burgun në Mitrovicë ia marin ata dhe disa dyqane ia konfiskojnë. Ai zgjedhë me jetu në periferi se ajri ma i pasur. Shkon gjyshi atje dhe ia konfiskojnë. Pas kohës ose në kohën kur lejohej kthimi i pasurisë e ka kthi daja. Gjyshi ma nuk ishte po daja i ka kthi. Disa, jo krejt. Disa prej pronave. Po babës tim jo, nuk ka pasë.

Anita Susuri: A nana juj a ka qenë amvise? A ka punu nana?

Milajete Shala Mehmeti: Amvise nana. Kta janë martu, baba edhe nana, pse dy familje që kanë qenë emblematike.

Anita Susuri: E nana juj çfarë familje i përket?

Milajete Shala Mehmeti: Qasaj të gjyshit.

Anita Susuri: Çfarë mbiemri kanë?

Milajete Shala Mehmeti: Dubella. Ata familja e gjyshit ose e nanës kanë ardhë nga Mirdita, ashtu e di unë.

Anita Susuri: E qysh ka qenë jeta kulturore në atë kohë?

Milajete Shala Mehmeti: Në Mitrovicë nuk ka qenë ndonjë jetë kulturore e dalluar. Mas '68-tes filloj me u ngjallë. Edhe pse ajo edhe përpara osht' pregadit. Që du me thanë që problemi osht' se nuk është leju me marrë frymë lirisht popullata. Sidomos në Mitrovicë gjithmonë osht' bërë luftë më e madhe, sikur tash që e shifni. Krejt qytetet janë më të lira në Kosovë se Mitrovica. Pra, aty është bërë lufta gjithmonë. Pastaj, shifet në vitet e '70-ta lulëzon ekonomia, kultura. Shumë gjëra në Mitrovicë. Qytet industrial. Mu m'kujtohet vetëm ni shtëpi e kulturës e vogël. Po në vitet e '50-ta as në qytete tjera nuk kishe shtëpi të kulturës. Ma e zhvilluar ishte Mitrovica m'duket në atë kohë sesa Prishtina. Sepse aty ish industria. Prej shumë vendeve shpërngulen shqiptarët dhe vijnë në Trepçë me gjetë punë, me jetu. Kjo osht'.

Anita Susuri: Në shkollë të mesme ju keni qenë në shkollën e mesme në Mitrovicë? Qysh ka qenë? A ka pasë shumë vajza?

Milajete Shala Mehmeti: Shkolla e mesme nëpër të gjitha republikat e atëherëshme të Jugosllavisë ka pasë nga një shkollë të mesme të këtij lloji. Sepse në shekullin e 19 ma shumë ishte industria e zhvilluar e këtyre degëve. Teknologjia, kimia, këto ishin në atë shekull. Në çdo republikë ka pasë nga një shkollë të mesme të këtij lloji, teknike. Në Kosovë ka qenë kjo në Mitrovicë. Prej të gjitha vendeve vijshin ktu me u shkollu. Unë e kom kry këtë shkollë të mesme. Qëllimi poashtu i imi ose i familjes time ka qenë që ta kryj këtë shkollë të mesme që t'jem kuadër për Trepçën. Kjo shkollë e mesme të pregaditke kuadro për laboratore. Labororet ishin atëherë ato që pregadisnin lëndën e parë, bënin hulumtime. Shumë kishte.

Dy profesione ishin. Shkolla e mesme normale që për msusi dhe kjo kur u hap që t'krijohen laborante për Trepçën. Ktu kishte shumë femra sepse meniherë gjenin punë dhe laboranti ish diçka shumë e përshtatshme për femra. Punojshim me ato enë që ishin ma të sofistikuara. Durtë pregaditeshin. Disa analiza, ku ta di unë. Pra, laboranti sikurse edhe mësuesja ishin dy profesione që ishin shumë me rëndësi për femra. Prandaj, në atë shkollë kishte bukur shumë femra, bukur shumë.

Anita Susuri: A keni pasë profesora shqiptar a po si?

Milajete Shala Mehmeti: Ne në fillim nuk ka pasë profesora shqiptar, pak ndonjë gjuhë. Sepse ata marrin mësim nga gjimnazi, shkollat e tjera profesionale. Matematicient kishte shqiptarë. Në kohën time u reduktua numër ma shumë kishte shqiptar sesa serb. Shumë pak kishte. Po landa ma profesionale që ishte quhej operacione teknologjike. Domethanë shumë profesionale ishte ajo, nuk kishte shqiptarë. Ma vonë u zëvendësua me shqiptarë, ma vonë.

Anita Susuri: Ju keni pasë edhe punën praktike sigurisht?

Milajete Shala Mehmeti: Ne pas, pra, kur përfundonte viti, gjatë pushimit të verës bënim praktikë feriale quhej. Shkonim në reparte të Trepçës ose kujdo që jetonin. Se aty kishte prej Suharekës, prej

Rahovecit. Ata i kishin fabrikat e veta. Aty mund ta bënë. Gjatë vitit kishin laboratore. Mund të thuhet që laboratorët e shkollës së mesme në atë kohë ishin ma të pregaditura sa ato në fakultet. Sepse kjo shkollë u ndërtua me fonde të industrisë dhe laboratorit... nuk mundesh ti me qenë inxhinier pa bo punë praktike. Laboratorët u pajisen mirë. Fakulteti u formu me pregaditje kryesore. Po shumë shpejt u ndërpre. Sa u formu. Unë u regjistrova pranë viteve të '70-ta fakulteti dhe sa i nxjerrën do kuadra. Laboratore fillestare. Kur duheshe të zhvillohej fakulteti atëherë filluan sulmet nga Serbia. Mbeti gjysë.

Anita Susuri: Po du me folë pak për jetën sociale të kohës të shkollës së mesme ku keni qenë. Kanë qenë edhe disa ballo, disa vallzime që kanë qenë po sa kanë shku?

Milajete Shala Mehmeti: Ju thashë unë që në Mitrovicë ka qenë një shtëpi e kulturës shumë e bukur. Aq sa zente aty. Organizoheshin do ballo po nuk mbrija në ato. Dikund në studime niherë fillun në Prishtinë pastaj u kthyn në Mitrovicë e tjera e tjera. Kisha punë tjera. Po ka pasë ni jetë mund të thuhet që sociale, modeste.

Anita Susuri: E përmendet këtë kohën e shkollës së mesme edhe m'tregut pak për jetën kulturore si ka qenë. Po po m'intereson edhe ma shumë ndonëse ka pasë ndonjë shfaqje teatro që keni shku?

Milajete Shala Mehmeti: Jo nuk ka pasë. Shqip jo. S'ka pasë në Mitrovicë. Në Prishtinë nëse ka pasë, ne atëherë kishim tjera probleme. Por nuk ka pasë. Ni jetë sociale jo. Jo që unë muj me folë. Pra, gjenerata ma t'vjetra ndoshta.

Anita Susuri: Fakultetin pastaj e keni regjistru në Mitrovicë?

Milajete Shala Mehmeti: Në Prishtinë filloj edhe pastaj u kthym në Mitrovicë. Ka ndodhë disa prap në Prishtinë. Përfundimisht në Mitrovicë. Sepse domethanë për shkak të Trepçës.

Anita Susuri: M'thatë që keni shku edhe praktikë me bo në Trepçe, a ju ka ra me hy edhe në zgafellë?

Milajete Shala Mehmeti: Jo. Sepse ne ishim degë e teknologjisë, xehtarët... aty ka pasë teknologji, xehtari, metalurgji. Ne praktikën e bonim ma shumë nëpër laborator. Unë praktikën e kam bo në fabrikën e, në elektrolizën e zinkut kryesisht. Ndonjëherë në fabrikë të akumulatorëve. Përfundimisht diplomën e kam punu në elektrolizën e zinkut, në repart. Profesori, mentori i diplomës ka qenë profesor Fatmir Rakolli i ndjeri. Ai ka qenë ndër drejtorët e Trepçës. Po neve na mbante ni landë shumë me randësi teknologjie që ishte... unë te ai e mora diplomën. E zgjedhnim me dëshirë diplomën. Unë punova ai ma rregulloj në elektrolizën e zinkut. Çdo ditë merrja elektrolik nga fabrika dhe atë hulumtoja. Ni laborator t'vogël e organizoja.

Anita Susuri: A kanë qenë laboratorët e pajisur mirë në atë kohë? A kanë pasur gjërat e nevojshme?

Milajete Shala Mehmeti: Në fabrikë po, sigurisht. Fabrikat kanë punu me kapacitet qind për qind. S'ka pasë ngecje aty. Sepse Trepça ishte ndër fabrikat në ish Jugosllavinë, miniera. Ajo lëndën e parë e merrnin disa degë në Kosovë që ishin nga Trepça, nga Mitrovica.

Anita Susuri: Kur fillut pastaj ju me punu në fakultet?

Milajete Shala Mehmeti: Unë fillimisht mas dy vitesh, pra, kur kryva dy vitet e para shkova me punu në shkollë teknike. Meniherë mas diplomimit në fakultet.

Anita Susuri: Në cilin vit keni diplomu?

Milajete Shala Mehmeti: Diplomova në '75-ten, '74-ten, '75-ten.

Anita Susuri: Si ka qenë përvoja në fakultet? Sigurisht ka pasë shumë nxanësa? Të Mitrovicës ndoshta ma shumë?

Milajete Shala Mehmeti: Shumë studenta. Nga të gjitha qytetet e Kosovës. Kjo ishte një nevojë për hapjen e këtij fakulteti sepse edhe industria, fabrika që ishin në Kosovë, ishin si me thanë, vazhdimësi e Trepçës. Gjithmonë landa e parë e merrnin nga Trepça dhe hapej nga ndonjë fabrikë, edhe punësimi. Fabrikë përpunuese. Nuk shitej vetëm lënda e parë por gjithkrah përpunohej. Si rezultat i kësaj binim prej shumë vendeve të Kosovës në fakultet. Pra, ma së shumti kishte dega jonë studenta. Teknologjia ma së shumti kishte. Këto degë tjera kah pak. Atëherë e di që thonin që ne po ju furnizojmë edhe juve, degët e tjera. Se ma së shumti kish. Po femra pak, nja dy a tri. Qashtu. Shumë pak femra.

Kusht ishte që ne në fakultet të punojmë por edhe të mendojmë për shkollimin tonë. Nuk mjaftonte vetëm fakulteti. Duheshe në atë kohë master që po thonë tash. Nuk ishte magjistratura ose mastër nuk kishte ni vit magjistraturë, megjithatë magjistratura ishte nivel ma i naltë. Fakulteti ishte katër plus ni, pesë vjet gati. Pastaj duheshe magjistraturë. Ne shkonim n'fillim, shumë kuadra tona në Beograd kanë kry edhe fakultet edhe magjistraturë. Ma vonë, kur u acaru shumë, fillun në Zagreb të shkojnë. Unë kom magjistru në Zagreb. Pastaj unë vazhdova doktoratën, kjo ishte kusht për me punu në fakultet, po ashtu në Zagreb. Kjo ishte ni praktikë që mbrojtja e doktoratës të bëhet në fakultet ku punon. Quhej [nuk dëgjohet] doktoraturë, ashtu quhej.

Mbrojtja të bëhet ku punon që të bartet praktika. Të shohin studentat e tjerë. Pra, ti masi kryen hulumtimin e mbrojtjen pa u pa kurgjo. Edhe ajo është pjesë e ligjeratës. Unë e mbrojtja në vitin '91, kur ishte problem shumë. Gjithçka u acar. Atëherë e mbrojtja doktoratën në Mitrovicë. Mas Grevës së Minatorëve kur ne fillim të ekspozojmë ma shumë, u acarum. Aty ishte... na u vë kusht a e përkrahim grevën a jo. Unë e mbrojtja. Mentori që nga Zagrebi që ishte kroat, shumë i vjetër, ma i njohuri në degën time në ish Jugosllavi. Ai nuk mujti me ardhë. Por, por, si anëtarë të komisionit e kërkoj një serb i

cili ishte poashtu kuadër i atij instituti ku unë isha. Por quhej Akademia Ushtarake e Zagrebit. Ishte ni serb. Po shumë korrekt.

Pastaj, ni serb nga Beogradi që profesori im e kishte koleg, e thirri dhe i tha, “Ti duhet me shku në vend timin”, ai ishte i pari në komision. Dhe ni tjetër nga Bori i cili mbante mësim në fakultetin tonë. Të gjithë ishin shumë korrekt. Unë e mbrojtja temën e doktoraturës në kohën ma të vështirë në Kosovë. Ose filloj koha e vështirë. ‘91-shin. Po ju që pyetët të kthehem nga ajo pyetja e juaj. Qaq shumë kishte studenta që amfiteatri që zakonisht quhej amfiteatër, ni sallë e madhe ku mbaheshin ligjeratat për grupin që ishin shumë të mdhaja, u mbush plot. Në të dy anët edhe filluan të qëndronin në kamë. Ishte edhe kohë e homogjenizimit të popullatës. Atëherë çdo tubim që ishte i joni, ti i shihshe plot aty. Ajo ishte. Shumë mirë kalova, korrekt ishin ata. Është ajo kohë e vështirë. Duhej të koncentrohesha që të përgjigjem sa më mirë.

Pjesa e Dytë

Anita Susuri: Profesoreshë në fakultet keni fillu pas diplomimit apo?

Milajete Shala Mehmeti: Po, pas diplomimit të fakultetit.

Anita Susuri: Pas ‘91-tes domethanë.

Milajete Shala Mehmeti: Jo, jo.

Anita Susuri: Pas ‘75-tes.

Milajete Shala Mehmeti: Fakultetin e kryjta dhe fillova. Se nuk mundesh pa diplomu me punu n’fakultet por magjistraturë dhe doktratura ishin pjesë e kualifikimit për fakultet. Nuk mjaftonte vetëm fakulteti. Pas diplomimit tim pas pesë-gjashtë mujsh na pushuan nga puna. Unë diplomova në mars, aty është saktësisht kur. Ne në shtator nuk kishim punë, në qershor na ndërpreu.

Anita Susuri: ‘91-ten?

Milajete Shala Mehmeti: ‘91-ten.

Anita Susuri: Po du me u kthy te ‘81-ta pak.

Milajete Shala Mehmeti: Kshtu ‘81-ta ishte, ‘85-ten u servu diçka. Mund të thuhet që ‘85-ten ne gati ishim si të pushuar nga puna. ‘81-shin demonstrata të mdha. Aty demonstratat i ndërpreu shumë në mënyrë brutale. Pastaj filloj meniherë diferencimi. Ashtu quhej. Ne ishim tri femra që punonim në

fakultet. Afërdita Nura, Luljeta Pula dhe unë. Tashti ishim ndër ma të rejat ose ma të rejat. Studentat shiqonin ne. Ne qaq ishim të lidhura me studenta saqë nuk e dinim rrezikun. Si ata si ne.

Mas demonstratave që thashë u thyn me brutalitet, me shumë dhunë, shumë studenta i çuan në spital. Qaq shumë domethanë i rrahën, përdorën forcë, i bon për spital. Mas asaj shpejt diferencimi. Që ta shohin a e provojmë ne a jo. Ne ishim ne trijat e para të cilat këtë e provuam. Erdhën në komitetin që vishin atëherë. Mu më kujtohet që u ulën ata dhe tash demek po diskutohemi qysh, si e aprovojme dhunën. Ne nuk e aprovuam dhunën dhe u çuam, ishim të zëshme te trijat. Ndonjë aty këtu s'di prej burrave, mashkujve. Të nesërmen gazeta serbe shkruan sa mujtën. *“Tri profesorke na pozicijama albanskog nacionalizma i iredentizma.”* m’kujtohet ky titull. Pra, ‘Tri profesoresha’, nuk e di a kuptoni serbisht?

Anita Susuri: Po.

Milajete Shala Mehmeti: ‘Në pozita’ dhe aty filloj lufta kundër nesh. Ne megjithatë nuk na larguan si i larguan të tjerët. Po lufta bëhej gjithnjë më e ashpër prej ‘81-shit. Na me t’gjithë kolegët e mi aty ku s’kishte mundësi manim mësim edhe në shqip edhe në serbisht. Pas ‘81-shit, vjen vendime a si quhej ajo që shqiptarët nuk bon me mbajtë mësim paralelet serbe. Vetëm shqiptarët. Ne ma nuk mundeshim të mbanim mësim te serbët. Angazhuan ata do asistente. Unë që kisha asistente ni kolege serbe, me të cilën kom pasë marrëdhanie korrekte, asaj ia dhanë ligjeratën. Ajo mbante serbisht. Prej meje ajo i mori të gjitha udhëzimet çka nevojitet për ligjerata dhe librat poashtu. Të cilat unë i përdorsha. Shumë korrekte. S’kam pasë problem. Megjithatë këtu filloj lufta.

Anita Susuri: Tregut edhe për ni studente malazeze që e keni pasë?

Milajete Shala Mehmeti: Po. Në atë kohë kur maja edhe serbisht mësim kisha studenta ju thashë prej gjithë Jugosllavisë aty n’fakultet. Ka qenë lënda ime shumë specifike, elektrokimia. Elektrokimia e teorisë edhe praktike. Praktike ishin këto metodat e prodhimit të metaleve të ndryshme. Një metodë që ishte shumë specifike ishte prodhimi i aluminit, si edhe sot është shumë me rëndësi. Të gjitha metalet. Metoda e prodhimit të aluminit është shumë specifike. Në Kosovë nuk prodhohej alumini se s’kishim alumin. Landa e parë që nxirrej nga Trepça nuk kishte për alumin. E vetmja fabrikë prej në atë kohë që e kishim studentat ne ishte në Podgoricë. Alumini prodhohej me qat’ metodë që ne, unë e ligjerojsha, ishte pjesë e landës time. Në Podgoricë alumini prodhohej.

Unë pikërisht se e kisha ni studente në grupin serbisht nga Podgorica. Ajo vendosi ta marr temën e diplomës, se zakonisht atëherë shiqohej ku p’e merr temen, që ta bëjë pjesën praktike në fabrikë. Ajo ishte e Podgoricës dhe ka deshë ta marrë qat’ temë të diplomës që ta punoj atje, s’kishte kurgjo të keqe. Unë në atë kohë u martova, lindjen e kisha. Atëherë lindja ishte nantë muaj. Në ndërkohë vjen afati se kanë procedu të mbrojtjes së diplomës. Çka me bo unë jam në pushim. Në vend timin kolegu

im, burri im bëhet anëtarë i atij komisioni se tha, “Ajo nuk deshti me ndrru”. Sigurisht që kanë kërku. Që ishte shumë... e vetmja prej grupit serbisht që e ka pasë diplomën te une. Dhe e mbron ajo, e kryen.

Anita Susuri: E me bashëshortin keni qenë koleg?

Milajete Shala Mehmeti: Koleg.

Anita Susuri: Ashtu jeni njoftu?

Milajete Shala Mehmeti: Po. Jemi njoftu në shkollë të mesme.

Anita Susuri: thatë që deri në ‘91-ten keni punu, pastaj në shtator janë largu...

Milajete Shala Mehmeti: Po, në qershor na kanë largu. Në shtator përfundimisht. Ishte greva që në shtator.

Anita Susuri: Po kthehem të ju pyes se e përmendet pak Grevën e Minatorëve, si ka qenë situata gjatë kësaj kohe.

Milajete Shala Mehmeti: Ato ishin, Greva e Minatorëve ishte pasojë pas ‘81-shit. Filloj Serbia t’i bëjë ndryshimet kushtetuese në kushtetutën tonë që ishte e njohur Kushtetuta e vitit ‘74. Që i fitum ne ato të drejta me kushtetutë. Por, kishte ni lidhje me Serbinë. Se demokraci si krahinë e Republikës së Serbisë. Serbia e pa që ne fillim të zhvillohemi si popull. Meniherë pas ‘81-shit, pas vdekjes së Titos fillon degradimi. Përfundimisht fillon me ndryshimet kushtetuese dhe Greva e Minatorëve ishte protestë kundër ndryshimeve kushtetuese. Kjo ishte. Atëherë fillon diferencimi shumë i madh.

Anita Susuri: Në vitin ‘91 pastaj pas largimit prej punës si ka vazhdu organizimi?

Milajete Shala Mehmeti: Në ‘91-shin përpara se të largohem nga puna, fillon organizimet e popullatës LDK-ja formohet. Në kuadër të LDK-së ishte edhe Forumi i Gruas i LDK-së. Kto formoheshin nëpër qytete sikur për LDK edhe për forumin. Unë isha kryetare e Forumit të Gruas të LDK-së, Dega në Mitrovicë. Pastaj shpejt u organizu kuvendi i parë zgjedhor dhe unë mora pjesë në atë kuvend të LDK-së. Aty u zgjedh ni këshill qendror që quhej. Me votime në mënyrë demokratike mund të thuhet. Unë u zgjedha anëtare e këshillit qendror. Prej aty, zgjedha kryetare e forumit dhe vazhdova si kryetare e Forumit të Gruas.

Anita Susuri: Cili ka qenë roli juaj? Çka keni bo?

Milajete Shala Mehmeti: Nuk, nuk kishim naj rol kryesor. Megjithatë, megjithatë bëhej ni qëllim. Qëllimi që edhe gruaja t'ketë organizimin e vet. Kshtuqë çka mujshim diçka. Nuk muj thom që, por në kuadër të LDK-së gjithmonë. Ni organizim ma i mirë.

Anita Susuri: Sa ka qenë vështirë me bo mbledhje të tilla?

Milajete Shala Mehmeti: Ne takoheshim niherë në javë sikur edhe LDK-ja. Niherë në javë të gjitha degët. Po kishin disa aktivitete nëpër ditë të ndryshme në ditë të Kosovës. Lehtë nuk ishte me shku n'atë kohë nëpër degë të ndryshme. Megjithatë mundoheshim që takimet mos t'jenë numër shumë i madh. Kryesia atëherë numëronte njëmbëdhjetë anëtare m'doket. Mundoheshim t'mos bëjmë tubime t'mdhaja se fort nuk kemi qenë të kursyne për qëllime t'mdhaja. Ne si bojshim tubime t'mdhaja policia meniherë alarmohej.

Anita Susuri: Policia a hynte brenda në mbledhje?

Milajete Shala Mehmeti: Kur filloj takimet e gjata atëherë ishin tubimet ma të mdhaja, atëherë. Por, thashë unë, takimet me degët i majshim në numër ma t'vogël. Por rrugës t'u shku ta zëm në Pejë, në Gjakovë shkonim nganjëherë. Atëherë na nalte policia kapak. Po mujshim... fort nuk kem pasë problem.

Anita Susuri: Në mbledhje për shembull të Forumit të Gruas, a është marrë në atë kohë, ende fillimi i '90-tave ka qenë. A është marrë ndonjë vendim çka me punu ose si me punu ose si me organizu forumin?

Milajete Shala Mehmeti: Sigurisht po. Ne kur u formum si forum ishim degë me thanë, pjesë e LDK-së, në ato takime që i majshim niherë në javtë me kryetarin Rugova ose kur s'ishte ai na mbante Agani. Ne i merrnim disa këshilla ose si duhet të punojmë, çka duhet të punojmë. Shpesh ka ndodhë që aty i kem marrë disa detyra të cilat janë kry me nder, gratë.

Anita Susuri: Çfarë detyra për shembull? Nëse mundeni me tregu?

Milajete Shala Mehmeti: Për shembull, kur u mbyllen shkollat fmija mbetën jashtë objekteve shkollore. Ne duheshe të interesoheshim si me ia bo me punën e fmive. Derisa u organizun shkollat private, që quheshin shtëpia. Atëherë deri atëherë ne si nana duhet të kujdesemi për fmi, kjo ishte. Gjithkush në mënyrën e vet.

Anita Susuri: A keni qenë pjesë e asaj kur osht' bo organizimi i shtëpive shkolla?

Milajete Shala Mehmeti: Po nuk kom qenë direkt me thanë por fillim u mundun me pengu këta. U vranë dy-tre mësues, i vranë. Shkolla e parë që u bo, u hap shpija e parë. Mu m'kujtohet që shkum me

Aganin aty. Ishte dikund në Dukagjin, s'më kujtohet cilin fshat që e lirun shpijen dhe meniherë e vranë ata. Pronarin edhe dy-tre veta, mësuesit.

Anita Susuri: Policia i ka vra a po?

Milajete Shala Mehmeti: Policia, po.

Anita Susuri: Nuk ju kujtohet kush ka qenë?

Milajete Shala Mehmeti: Jo, jo. Sigurisht janë emrat dikund. Por e di që vrasjet e para kanë qenë, meniherë. Se u mundun me ia ndalë hovin. Arsimimin paralele s'kishin mundësi me ndalë. Hajt se bohen disa bisedime, jo në shkolla... pa sukses. Ka pasë ni iniciativë që edhe nëpër fakultete niherë bon biseda t'mundohemi të kthehemi. Mu m'kujtohet që ne në Mitrovicë shkum. Ajo udhëheqja e hershme që quhej bashkë me Emin Dushin m'duket a s'di dikush kush ka qenë. Po pa sukses. Pa sukses. Ne e dinimin që veç formalitet ajo. Po mos me thanë që s'kemi bo bisedime. Kjo ka qenë.

Anita Susuri: Ju refuzun direkt a po?

Milajete Shala Mehmeti: Po mirë, na dëgjoj ai dikund i dhunshëm. Na dëgjoj dhe vendimi vijke nga lart. "Kurgjo s'o", tha, dhe nuk ndodhke kurgjo. Pastaj i mbajshim disa ligjerata nëpër objekte kshtu.

Anita Susuri: A jeni angazhu edhe ju si profesoreshë në shtëpi shkolla?

Milajete Shala Mehmeti: Po, po.

Anita Susuri: Në cilat vende keni qenë?

Milajete Shala Mehmeti: Ne kemi qenë ma së pari ni shkollë tetë vjeçare sa ishte në periferi të Mitrovicës. Pastaj krejt kohën gjithë aty kem majtë derisa na largun.

Anita Susuri: A ju kujtohet emri i asaj shkollës?

Milajete Shala Mehmeti: Jo nuk më kujtohet si quhej shkolla po ishte periferi dikund. Ni shkollë tetë vjeçare e fshatit.

Anita Susuri: Aty domethanë janë mbajtë ligjeratat për fakultet?

Milajete Shala Mehmeti: Po, aty.

Anita Susuri: Njëkohësisht, sigurisht edhe prej shkollës fillore kanë marrë pjesë në mësim.

Milajete Shala Mehmeti: Sigurisht. Ma vonë ishin ma liberal, i lanë fëmijët.

Anita Susuri: E në shtëpi kështu private a keni qenë?

Milajete Shala Mehmeti: Jo, unë jo.

Anita Susuri: E fakulteti...

Milajete Shala Mehmeti: Ma vonë, ne bom ni përpjekje që fakulteti të shkoj në Prishtinë. Në Velani në ni shtëpi private u vendos rektorati. Karshi saj me thanë nja ni vjet kemi mbajttë aty. Po, po. Pastaj, jo. Nuk mujtëm me marrë vendimin që t'kaloj fakulteti në Prishtinë u kthym prap në Mitrovicë.

Anita Susuri: E ktu në Prishtinë në atë shtëpi si ka qenë? A ka pasë kushte? Si kanë qenë kushtet?

Milajete Shala Mehmeti: Vetëm mësim, laboratore s'ka pasë. Fakulteti jonë pa repertur s'ka mundësi. Po aty kom majttë. Unë para asaj, para asaj gjendje kam shku në Gjermani dhe u ktheva që t'maj mësim. Pastaj, majtëm ni vjet në Velani, qaq.

Anita Susuri: Në cilin vit ka qenë kjo?

Milajete Shala Mehmeti: '95-ten.

Anita Susuri: A ka pasë shumë studenta që prap se prap kanë qenë të interesun?

Milajete Shala Mehmeti: Po, jo aq shumë. Sikur që kishim në Mitrovicë jo. Rrugë e lartë shumë edhe nëpër burgje. Shumë kishte studenta që morën pjesë në demonstrata, shumë. Ata ose ikën ose nëpër burgje që i zinin.

Anita Susuri: Po kanë qenë edhe këto në '89-ten, '90-ten, '97-ten.

Milajete Shala Mehmeti: Atëherë filloj. '81-shi ma s'kish kurgjo.

Anita Susuri: Juve a ju kujtohet për shembull çfarë atmosfere ka mbizotëru pa marrë parasysh të gjitha? Si ka qenë entuziazmi i studentëve? Sigurisht osht' dashtë vullnet shumë i madh me studiu në kushte të tilla.

Milajete Shala Mehmeti: Po entuziazmi ishte shumë i mirë, para '81-shit. Fakultet i ri dhe fillimisht ne në gjeneratë të parë ishim 20-30 studenta po pastaj shkonte t'u u rritë numri.

Anita Susuri: Po mendoj për vite të '90-ta.

Milajete Shala Mehmeti: Për vite të '90-ta, jo, pastaj fillun me u marrë edhe studentat që ishin rinia që udhëheqnin lëvizjen me punë tjera. Shkonte t'u ra interesimi. Shumë studenta pas viteve '90-ta kanë ardhë e kanë vazhdu fakultetin. Sepse mbet gjysmë. Për me regjistru pak shumë.

Anita Susuri: Çka ju kujtohet ende diçka prej aktiviteteve prej viteve të '90-ta që mendoni që është i rëndësishëm.

Milajete Shala Mehmeti: Pajtimi i Gjaqeve.

Anita Susuri: A keni marrë pjesë?

Milajete Shala Mehmeti: Po, qysh jo. Si kryetare e degës në Mitrovicë të forumit unë isha edhe anëtare e Degës të LDK-së në Mitrovicë. Kur... kryesisht ishin studentat tonë që ishin në lëvizje dhe kryetarët e degëve të LDK-së. Ku shkonte kryetari më thirrnin edhe mu, në pajtim të gjaqeve. M'kujtohet sa herë kemi qenë nëpër fshatra të ndryshme për pajtime.

Anita Susuri: A mundeni me na përshkru si kanë shku këto takimet, mbledhjet, naj rast i veçantë që ndoshta jeni prekë?

Milajete Shala Mehmeti: Ka pasë sigurisht çdo proces ka pasë vështirësi dhe dikund ka shku ma lehtë. Varej nga rasti. Ne, për shembull, Latif Berisha ishte kryetar i degës në Mitrovicë. Ai e zhvilloj ni strategji sikur Anton Çeta. Të bisedojmë shumë kadale në mënyrë qetësuese nëse mundemi me u pajtue. Hyrja që bënte, "Ne duhet të hegjemonizojmë, t'jemi bashkë". Kishte raste kur ma lehtë e arrinim po ato raste ma të vështira ishin ku merrte pjesë Anton Çeta. Aty ishin ma... këto rastet tona ishin ma të lehta. Pajtoheshin njerëzit. U pajtu u arritën disa pajtime.

Anita Susuri: Çka kanë qenë ndoshta rastet, nëse ju kujtohen? Pse kanë ndodhë ato vrasje ma shumë?

Milajete Shala Mehmeti: Vrasjet ishin nga më të ndryshmet. Se ka ndodhë... detalet s'më kujtohen.

Anita Susuri: Ju po m'duket në vitin '96 keni shku në Gjermani?

Milajete Shala Mehmeti: '92-shin.

Anita Susuri: '93-shin?

Milajete Shala Mehmeti: '92-shin.

Anita Susuri: Pastaj jeni kthy?

Milajete Shala Mehmeti: Pastaj jom kthy.

Anita Susuri: A mundeni me më tregu për punën e ju në Gjermani?

Milajete Shala Mehmeti: Në Gjermani ne shkum në ni universitet që ishte i njohur për do degë sikur gjithkund ka pasë, sikur fakulteti jonë. Pra, akademia që ishte e njohur në botë, 800 vjeçare. Aty përveç që kolegu dhe bashkëshorti im krynte doktoraturën, hulumtimet. Unë i bona disa specializime në fushën e korizionit. Sepse çdo metal e pson korozionin. E mësova qat' specializim. Bukur gjatë. Aty e shkrova tekstin për korizionin.

Anita Susuri: E di që m'keni tregu ju keni shërby edhe si përkthyes për refugjatë?

Milajete Shala Mehmeti: Në atë kohë sa isha në Gjermani, se kur filloj lufta m'kujtohet që pas ni kohe më thirrën që t'shkoj të përkthej për gratë që vinin. Mu m'kujtohet ni rast Poklek katuni, komuna e Drenasit m'duket. Dy motra. Motra ma e madhe që ishte nja 50 vjeçare dhe kjo tjetra 25. Ato nuk mundeshin me folë prandaj kanë kërku naj gru që t'ju ndihmoj. Dridheshin. Çka ju kanë bo, qysh kanë mujtë me dalë ato unë nuk e di. Por mu m'kujtohet që ai rast na ka trishtu shumë.

Anita Susuri: Ju '96-ten thatë që jeni kthy po pastaj prap...

Milajete Shala Mehmeti: Po prap kom shku prap qaty se i lash specilizimin. Vazhdova. Në vitin 2000 jom kthy përfundimisht.

Anita Susuri: E për luftën a keni qenë në kontakt me familjen këtu?

Milajete Shala Mehmeti: Gjithmonë, gjithmonë. Shumë keq. Unë e kom pasë ni kontakt, telefonat ishin rrallë atëherë. Niherë mobilia nuk ishte. Unë e kom pasë ni telefonik me vllaun dhe sa pritsha me u bo mëngjes me folë me atë. Çka ka ndodhë gjatë gjithë ditës, t'nesërmen prap e thirrsha. Këtu i kam pasë krejt familjen. Babën, nanën, vllaznit, motrat, nipat. Të gjithë kanë qenë.

Anita Susuri: A kanë qëndru në Mitrovicë a janë largu?

Milajete Shala Mehmeti: Atëherë në momentin e fundit janë largu pak po janë kthy prap, krejt. Nuk ka prej tyne jashtë.

Anita Susuri: në vitin 2000 thatë që jeni kthy dhe e keni pasë ni rol shumë të rëndësishëm pastaj.

Milajete Shala Mehmeti: Në vitin 2000 jam kthyer dhe ne së pari u kthym me kolegun tim dhe bashkëshortin tim me një projekt shumë vjeçar që ishte projekt shumë i madh. Ne punuam para se të vijmë shumë për të. Me atë projekt furnizohem në laboratore, që ishte shumë i nevojshëm, i dërguam një 200 studenta për punimin e diplomave magistraturave dhe doktoraturave në atë fakultet ku ishim ne.

Anita Susuri: Cili ka qenë fakulteti? Emri a ju kujtohet ndoshta?

Milajete Shala Mehmeti: Akademia e Frejbergut është.

Anita Susuri: A keni arritë ju me realizu?

Milajete Shala Mehmeti: Ne erdhëm me projekt shumë, shumë të shpejtë. Pa u ndërpre lufta. Njerëzit ishin me thanë, jo në gjendje të mirë. Disa kishin hupë familjar, disa... njerëzit me të gjitha streset. Sikurse kohë lufte. Nuk ishte bash lehtë me depërtu me një projekt të tillë. Ma së pari ishte e vështirë me gjetë objekt. Se ne si fakultet ishim pa objekt. Pas luftës e zënë, e zënë atë fakultetin tonë. Që nuk ishte objekt shumë i madh. Ne ishim pa objekt. Pajisjet të cilat shumë shpejt i prunët Gjermanit, s'ka problem i kishin pajisjet e gatshme. Vetëm duhej procedurat.

Ne nuk arritëm derisa e prunë ata, ku me i çu? Bom disa biseda në Fakultet Teknik në Prishtinë. Përfundimisht i çum në Fakultetin Filozofik që është qendër. Prej aty në Fakultet Teknik. Me shumë vështirësi kemi pasë, shumë. Ne u munduam të bëjmë diçka. Megjithatë për shkak të vështirësive të tilla nuk arriti projekti të realizohej qind për qind. Ideja e tyre që na dhanë projektin ishte që ta bëjnë në laborator qendror që do të shërbente si laborator për krejt rajonet. Kshtu ideja e tyre. Nuk patëm mundësi ashtu. E ndam laboratorin. Në pjesë këtu të Fakulteti Teknik. Pastaj neve na dha Trepça një objekt e në pjesë aty. Kshtu që ajo ideja nuk u realizu por shumë studenta kanë shku e kanë punu diplomën atje, shumë. Një 200-300 vetë.

Anita Susuri: A keni punu shumë pas luftës?

Milajete Shala Mehmeti: Po. Shtatë vjet ka që... deri atëherë kom punu.

Anita Susuri: Pas pensionimit a keni vazhdu me ndonjë aktivitet?

Milajete Shala Mehmeti: Jo. Unë kam qenë kryetare e bordit të një qendre për të rehabilitimin e të mbijetuarve të dhunës që quhet KRCT. Qatë kam qenë. Aktivitetin e kom vazhdu deri para një viti qashtu.

Anita Susuri: A ka qenë punë e vështirë?

Milajete Shala Mehmeti: Jo. Unë vetëm bordi. Takoheshim niherë në gjashtë muj. Po disa herë kam marrë pjesë në aktivitete. Nuk ishte punë e vështirë.

Anita Susuri: Zonja Milajete nëse doni edhe diçka me shtu, nëse kom harru diçka me përmend?

Milajete Shala Mehmeti: Gjatë punës në fakultet unë kam pasë ni bursë e cila osht' pra dy herë kom qenë në Amerikë. Niherë 2003-shin nëpërmjet ni që quhej How Fellowship. Gratë lidere, kshtu ishte projekti, meniherë e organizonte USAID. Ne morëm pjesë gratë nëpër sektor të ndryshëm. Ishim njëmbëdhjetë femra aty. Nja dy-tre muj qashtu. Pregaditeshin gratë lidere. Pas asaj kohe unë kur erdha punova pak në Ministrinë e Arsimit dhe pastaj prap shkova në fakultet. Ajo ka qenë. Unë s'isha e interesune për udhëheqje, ma shumë për arsim. Herën e dytë 2006-ten unë konkurova për ni bursë që quhej *Fulbright* bursa, dhe ma dhanë aty për katër muaj. Shkova poashtu në Amerikë në Universitetin John Hopkins. aty e kryva ni specializim, u ktheva.

Anita Susuri: Çfarë specializimi ka qenë? Për drejtimin e juj apo...

Milajete Shala Mehmeti: Po, për drejtimin tim.

Anita Susuri: Si i keni vërejt këto për shembull dallimin e laboratorëve ose kushteve me Amerikë?

Milajete Shala Mehmeti: Niherë nuk kishim laborator. Ne atëherë u munduam ta bëjmë ni laborator, qaq. Kur u kthym prej Gjermanisë. Nuk krahasohej. Pastaj ne ende jemi shoqëri e dalur nga lufta, aq ma tepër 2003, 2006.

Anita Susuri: Zonja Milajete faleminderit shumë!

Milajete Shala Mehmeti: S'ka përse.